

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I
SHOQERISE TREGETARE

Ne Pogradec sot me date 28 Shkurt 2025 ,ne respektim te kerkesave te nenit 230 te ligjit nr. 9901 , date 14.4. 2008 “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “, personat: 1-. Leonart Bregu , i biri i Samiut, lindur me 20.11.1968 ne Leminot , rrethi Korce, banues ne Pogradec, 2- Aleko Bregu, I biri I Samiut, lindur me 20.04.1971 ne Leminot rrethi Korce banues ne Pogradec, 3- Ilia Bregu i biri I Samiut lindur me 13.06.1968 ne Leminot Korce, banues ne Pogradec vendosin te themelojne shoqeri tregetare per aktivitet tregetar.

F O R M I M I

Neni 1

Shoqeria tergetare me emertimin “ BREGU ENERGY “ sh,p.k eshte shoqeri me pergjegjese te kufizuar, shoqeri e te drejtes juridike shqiptare .

Shoqeria “BREGU ENERGY” sh.p.k eshte nje shoqeri tregetarre e themeluar nga tre ortakë :

1.Leonart Sami Bregu datelindja 20.11.1968 zoteron 34 % te kuotave ne kapitalin e shoqerise , 2.Aleko Sami Bregu datelindja 20.04.1971 zoteron 33% te kuotave ne kapitalin e shoqerise, 3. Ilia Sami Bregu datelindja 13.06.1975 zoteron 33% te kuotave ne kapitalin e shoqerise. Ortaket gezojne te drejtat nga shoqeria sipas perqindjes qe ata kane ne kuotat e kapitalit te shoqerise .

S E L I A

Neni 2

Selia e shoqerise tregetare “ BREGU ENERGY“ sh . p. k eshte ne qytetin e Pogradecit , adresa :Korce, Pogradec, Pogradec , Ruga nacionale Pogradec-Korce ,Lagja nr . 1 , prane tek ish ” karburanti i shtetit”. Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithë teritorin e Shqiperise dhe jashte saj . Per kete ajo mund te hap seli te tjera operative , filijale ,perfaqesi, agjensi me te gjithë teritorin e Shqiperise dhe jashte saj, konform ligjeve te vendeve ku ato hapen, me vendim te organeve drejtuse te shoqerise.

KOHE ZGJATJA

Neni 3

Kohezgjatje e veprimtarise ekonomike te shoqerise tregetare “BREGU ENERGY “ sh.p.k. eshte e pakufizuar . Por ajo mund te shperbehet ne cdo kohe .

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 4

- Aktivitetet ne fushen e shitjes dhe te tregetimit te karburanteve te te gjitha llojeve, me pakice ne dyqane te specializuar.

-Veprimtari tregetare ne fushen e ushqimit , bar restorante , hotele , motele dhe aktivitete turistike nepermjet agjesive turistike .

- Tregetim produktesh konsumi ,industrial e ushqimor ,lendesh te para , makineri e pajisje me shumice dhe pakice , eksport import , shitje material ndertimi.

-Aktivitetet ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjereve .

-Germime dheu e murature, beton-arme , prishje dhe punime me toke te germuar , prodhim te materialeve inerte e gure, ndertime civile e ekonomike, ndertim rruge , ndertim mbishtrese rrugore , punime karpenterie druri punime bojatisje hidroizolim ,termoizolim , izolim akustik ,kundra zjarrit etj.

-Aktivitete ne tregun e letrave me vlere dhe te aksioneve.

-Dhene me qira te pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme dhe shitblerjen e tyre .

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 5

Shoqeria “ BREGU ENERGY“ sh.p.k perbehet nga tre ortake: 1.Leonart Bregu me 34% te kuotave te kapitalit,Aleko Bregu me 33% te kuotave te kapitalit, Ilia Bregu 33% te kuotave te kapitalit.

Organi me I larte eshte ‘Asambleja e Ortakeve’, e cila:

- Administron aktivitetin e shoqerise ne perputhje me aktin e themelimit te ketij statuti
- Merr pjese ne fitimet e cdo lloji forme dhe sasije te aktivitetit te shoqerise, te parashikuar ne aktin e themelimit e te Statutit.
- Drejton shoqerine dhe e perfaqeson ate ne cdo lloj aktiviteti.
- Ndjek dhe perfaqeson shoqerine ne te gjitha fushat e aktivitetet te saj.
- Percakton politikat tregetare te shoqerise.
- Emeron dhe shkarkon administratoret e shoqerise .

- Percakton shperblimet ne shoqeri.
- Mbikqyr zbatimin e politikave tregetare nga administratoret , perfshire edhe pergatitjet e pasqyrave financiare te shoqerise.
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise.
- Merr vendime per riorganizime dhe prishje te shpqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve rregjistrohen ne nje rregjister te vendimeve , te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen apo te fshihen.

Neni 6

DETYRIMET E ORTAKEVE :

- Depoziton kuoten fillestare dhe te nevojshme si dhe ato suplementare ne perputhje me aktin e themelimit e te Staturit.
- Merr pjese ne administrimin e shoqerise ne perputhje me organet e krijuar prej saj .
- Permbush te gjitha detyrimet per realizimin e objekteve te shkoqerise.

Neni 7

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin , seline , objektin dhe kohezgjatjen e saj, etj. me vendim te marre nga vete ortakët .

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 8

Kapitali shoqerise tregetare "BREGU ENERGY" sh.p.k eshte 100000 leke (Njeqind mije leke) i formuar sipas kriterave te caktuara ne nenet 5- 7 te Aktit te Themelimit te kesaj shoqerie , qe i bashkjengjitet ketij Statuti. Kapitali I shoqerise eshte nenshkruar dhe likujduar ne mjete monetare nga ortakët e shoqerise. Ortakët gzejne kuota te barabarta ne kapitalin e shoqerise prej 33.33 %. Ortakët prgjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 9

Kapitali i shoqerise tregetare mund te shtohet , ose te pakesohet sipas deshires dhe nevojave te ortakeve.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themelor , ortaket kane te drejten e perparesise ne nenshkrimin e perqindjes se rritjes , propocionalisht me kuoten e kapitalit fillestar .

Vendimi per ndryshimin e kapitalit I njoftohet Qendres Kombetare e Biznesit per regjistrim nga administratori ne baze te ligjit 9723 , date 03.05. 2007 “ Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”.

Pjeset e kapitalit themelor mund te fitohen apo te transferohen te persona te trete , qe nuk bejne pjese ne shoqeri, me deshiren e te gjithë ortakeve qe ka shoqeria . Ortaket ne kete drejtim veprojne me kopetenca te plota nepermjet: a) kontributi ne kapitalin e shoqerise , b) shitblerjes , c) trashigimise, d) dhurimit, e) cdo menyre tjeter e parashikuar ne ligj. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate kjo e fundit duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes , nga casti i kalimit te kuotes deri ne rregjistrimit nga ana e QKB-se.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferushme me rruge trashigimie.

Neni 10

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuse te shoqerise jane:

Asambleja , Administratori i Pergjithshem, Keshilli Drejtues.

Asambleja eshte organi sovran i shoqerise. Ortaket drejtojne shoqerine duke u mbeshtetur me te drejten e tyre te pronesise dhe te mjeteve te investuara ne shoqeri.

Asambleja e shoqerise percakton dhe miraton te drejtat dhe detyrat e organeve te saj, te administratorit te pergjithshem , te keshillit drejtues administrative.

Asambleja therritet dhe drejtohet nga ortaket e shoqerise .

Asambleja merr vendim ne perputhje me ligjet ne fuqi, ne perputhje me Statutin dhe me aktin e themelimit te shoqerise tregetare.

Cdo ceshtje dhe vendim qe merret Ortaket e shoqerise e rregjistrojne ne rregjistrin perkates te shoqerise tregetare.

Neni 11

Ortaket e shoqerise me ane te prokures se posacme dhe te pergjithshme mund te ngarkokje cdo person tjeter per t'u paraqitur para cdo organi shtetror, shoqeror apo juridik me te cilin zhvillon ose jo veprimtari, per ta perfaqsuar ate.

Neni 12

Si administrator i shoqerise “BREGU ENERGY” sh.p.k emerohet Z. Leonart Bregu, per nje periudhe kohe prej 5 (pese) vjet, nga data e perpilimit te ketij statuti,dhe me te drejte rizgjedhje.

Neni 13

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria tregetare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit shqipetar ne fuqi, vecanarisht me disopozitat uredheruese te ligjit “ Per shoqerite tregetare”.

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregetar te biznesit , si person juridik, gjithashtu rregjistrimin e njekohshem te saj prane autoriteteve tatimore ne skemen sigurimeve shoqerore e shendetesore dhe prane inspektoriatit te punes.

Emertimi i shoqerise , kapitali themelor dhe emerimi i administratorit te pergjithshem duhet te figurojejne ne te gjitha dokumentet e nxjerra prej shoqerise dhe qe ju drejtohet te treteve.

Neni 14

Shoqeria ka vulen e vete me permbajtje “ BREGU ENERGY sh. p. k karburant. “

Ajo ka llogari te sajen , ne leke dhe ne valute te huaj ne bankat shqipetare

Neni 15

Shoqeria tregetare “BREGU” sh. p. k vepron ne rregjistin e prones private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime kontraktore dhe jashtekontraktore brenda kapitalit te saj.

Neni 16

Administratori ka te gjitha te drejtat dhe kopetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise dhe per llogari te saj.

Neni 17

Administratori i pergjithshem eshte i veshur me te gjitha te drejtat per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa kufizim e perjashtim.

Ai ka te gjitha te drejtat per te vepruar ne emer te shoqerise dhe per llogari te saj per permbushjen e objektivave te shoqerise

Ai detyrohet te kujdeset dhe te mirmbaje dokumentat dhe librat kontabel te shoqerise Te pergatise dhe te firmos bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e mbarvajtjes te veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve, te paralajmeroje ne kohen e duhur per kercenimet qe I vijne shoqerise per nbarevajtjen e veprimtarise.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve , te statutit , apo per faje te tjera gjate administrimit te shoqerise.

Administratori , gjate kryrjes se detyrave te tij, pergjigjet para shoqerise per cdo veprim apo mosveprim gjate veprimtarise se shoqerise. Veprimi ne kundershtrim me detyrat dhe statuti dhe shkelja e standarteve profesionale , nga ana e administratorit , do te quhen shkelje dhe sipasojte do t e coje ne demshperblim te shoqerise nga ana e tij. Pra administratori eshte I detyruar te demshperbleje shoqerine per demin e shkaktuar.

Neni 18

Administratori, apo ortakët e shoqerise, lejohen qe si individ, te marri hua, te japin hua, te behet dorezanes, apo garant per persona te tjere ne emer te tij dhe te shoqerise se tij, te marri angazhime ndaj te treteve .

Neni 19

Pjeset e kapitalit themelor jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimije. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne ndarjet midis bashkjeshorteve, nderjmet te paralindurve dhe te pas lindurve.

Neni 20

MARDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes se shpqrise rregullohen sipas dispozitave te Kodit te Punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontrate une zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqipetar ne fuqi.

Shoqerija merr persiper qe te zbatoje dhe te respektoje rregullat e ligjet ne fuqi per punesumin , per sigurimet shoqerore. Te gjithë te punesuarit te kesaj shoqerie jane te detyruar te zbatojne normat e ketij Statuti dhe te Aktit Themelot te kesaj shoqerie.

Neni 21

Te punesuarit ne shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit per mos zbatimin e detyrave te ngarkuara si edhe per demet qe ata i shkaktojne pasurise se shpqerise . Ata mbajne pergjegjsi penale dhe administrative per mos kryerjen sipas ligjit te detyrave te ngarkuara.

Neni 22

Mosmarveshjet e te punesuarve ne shoqeri zgjidhen ne gjykatën shqiptare. Kur pala ankuese eshte person i huaj mosmareveshja zgjidhet ne organin e percaktuar ne kontratene punes .

Neni 23

Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit qe realizon shoqerija gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ekonomike ne se ne kontratën e punes eshte percaktuar ndryshe .

Administratori i emeruar nuk nund te marre cilesine e ortaut ne shoqeri, as edhe te ushtroje nje aktivitet konkurues te cdo lloj per llogari te tij ose te te treteve pervec e atyre te autorizuar nga administratori i pergjithshem i shoqerise tregetare, ndryshe si pergjigjet per demet e shaktuara dhe perjashtohet nga shoqeria.

SEKRETI I PUNESIMIT

Neni 24

Te gjithë te punesuarit ne shoqeri jane te deyruar sipas Kodit t e Punes qe te ruajne sekretin e punes se shoqerise, Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqerija si te punesuar .

Detyra mbi ruajtjen e sekretit te punes se shoqerise eshte e vlefshme edhe per ortaket dhe administratorin e shoqerise.

PERFQESIMI I SHOQERISE

Neni 25

Perfaqsimi I shpqerise “BREGU ENERGY” sh. p. k. behet nepermjet administratorit te emeruar nga asambleja e ortakeve te shoqerise, dhe te personave te tjere te paisur me procure prej tyre .

KONTROLLI I BRENDSEHEM

Neni 26

Shoqeria organizon kontroll te brendeshem me ekspert kontabel ne perputhje te ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per shoqerite tregetare "

Ekspertet kontabel kontrollojne dhe garantojne qe llogarite vjetore jane te rregullta dhe japin pasqyrim besnik te rezultateve dhe te operacioneve te vitit te kaluar financiar, te gjendjes financiare e te trashегuar te shoqerise ne fund te vitit financiar.

Ata kontrollojne pershtatjen e kontabilitetit te shoqerise me legjislacionin ne fuqi . Ata jane pergjegjes ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nga nga nenvleftesimin e tyre ne ushtimin e detyres se ngarkuar.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 27

Veprimet ekonmike dhe financiare te shoqerise mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti, me perjashtim te rasteve te caktuara ng administratori e pergjitheshem.

Ne fund te cdo periudhe te aktivitetit, administratri i Pergjithshem i shoqerise nxjerr bilancin kontabel me llogarine humbje e fitime, inventarin dhe raportet perkatese me perputhje me dispozitat ligjore te kontabilitetit si dhe harton raportin me shkrim.

Raporti i administratorit, inventaret, bilancet dhe llogrite vjetore te hartuara nga adminisdtratori i pergjithshem i nenshtrohen miratimit te asamblese se shoqerise, brenda nje afati prej tre muaj nga data e mbylljes se llogarive financiare .

Me miratimin e bilancit kontabel vjetor shoqerija vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillumin e saj , si fondi rezerve, ate te akumulimit , etj.

Neni 28

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve te mesiperme dhe shlyerjes se detyrimeve fiskale dhe atyre me te tjeret i mbesin ne perdorim , pronesi ortakeve te shoqerise , te cilet i perdorin per nevojat e veta si prona te tyre te ligjeshme private .

Neni 29

Dividente qe nuk korespondojne me fitimet e realizuara mund te reklamohen

Neni 30

Shumat e rezervuara mund te shperndahen.

Neni 31

Ne seline e shoqerise mbahet dokumenti i plote i saj, si dokumente themeluese te shoqerise, dokumente qe rregullojne maredheniet ekonomike te shoqerise me te gjitha ndryshimet deri ditën e fundit.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 32

Shperberja e shoqerise tregetare mund te vije ne cdo kohe dhe cdo shkak, si ne raste falimentimi, privimi te te drejtave per te ushtruar profesionin e veprimtari private, force madhore , ne raste lufte, cdo faktor tjetër qe nuk varet nga vullneti i ortakut te vetem te shoqerise , por gjithmone me vendim te mbledhejes se jashtezakonshme te Asamblese se shoqerise.

Ne keto raste asambleja e shoqerise vendos mbi natyren e likujdimit te shoqerise duke percaktuar nje ose me shume likuadator dhe percakton detyrat e tyre .

Ne raste likujdimi te shoqerise emertimi i saj pasohet nga shoqeri sh.p.k ne “shoqeri ne likujdim “.

Likuadatorët dhe administratorët janë përgjegjës për veprimet për likujdimin e shoqerise. Ata kujdesen për të likujduar në radhë të parë detyrimet e shoqerise ndaj të tereve. Mbas pagimit të kreditorëve , pjesa tjetër që mbetet mbahet nga ortakët e shoqerise.

Ne fund të cdo procesi të likujdimit, Asambleja vendos mbi biznesin perfundimtar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit. Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likujdimit dhe kryhet formaliteti i likujdimit shoqeria cregjistrohet nga regjistri tregetar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete Statut i referohet legjislacionit ne fuqi .

Ndryshimet e plotesime e ketij stauti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete Statuti i shoqerise , duke mbajtur parasysh kerkesat e ligjit Nr.9723 dt. 03.05.2007“ Per Qendren Kombetare te Biznesit”

Neni 34

Cdo ndryshim e plotesim e Statutit nuk duhet te prek peronalitetin juridik te shoqerise tregetare.

Per mosmarveshje qe mund te lindin ne zbatimin e apo interpretimi i ketij statuti, si edhe per cdo mosmarveshje qe mund te lind midis shoqerise dhe te te tereve, kopetence do te jete gjykata shqiptare.

Neni 35

Ky Statut perpilohet ne kater kopje , ne gjuhen shqipe, dhe me vlere te njejta juridike.

ORTAKET E SHOQERISE

1. Leonart **BREGU**



2. Aleko **BREGU**



3. Ilia **BREGU**

